

NE, BASHKËPUNËTORËT E MILLOSHEVIÇIT

JEAN BAUDRILLARD

Do të duhej së paku të nxirreshin arsytet cinike të kësaj "luftë", arsytet e parrëfyera të kësaj ndërhyrjeje, që thuhet se është një dështim, një katastrofë nga të gjitha aspektet. Dhe pikërisht në këtë pikë na vjen një dyshim mizor rreth gjithë këtij inskenimi.

Shumë gabime të akumuluara, shumë dredhime dhe shumë aksione të pakryera, duhet me siguri të kenë një kuptim dhe kjo këmbëngulje në rrëmujën aktike, në këtë luftë të pafrytshme që e dështon thujtse qëllimisht synimin e saj (flas për perëndimorët: Millosheviçi nuk e gaboi synimin e tij), e gjitha kjo do të të bënte të dyshojë për vetë përkufizimin e luftës: vazhdimi politikës përmes mjetesh të tjera.

Nëse ky përkufizim vlen ende, atëherë të gjithë strategët dhe politikanët tanë perëndimorë janë idiotë, – mundësi që nuk përjashtohet, – por para se të arrijmë te ky ekstrem shtrojmë pyetjen nëse, përkundrazi, mos janë duke çuar përpara e duke kryer një operacion përsosmërisht të programuar, i cili, gjithsesi, zhvillohet sikur të ishte i tillë.

Thuhet: NATO vazhdon të bëjë gabime. Europa nuk është në gjendje të ketë as më të voglën politikë të hartuar. Por jo, është krejt e kundërta. Çfarë bën Millosheviçi? Asgjëson minorancat e tij, në mënyrë të veçantë, natyrisht, minorancën myslimane, prandaj e gjithë Jugosllavia "e bardhë", katolike apo ortodokse, është me të. Por jo vetëm Jugosllavia. E gjithë Europa është me të. Të gjitha shtetet kombëtare europiane kanë probleme me minorancat e tyre etnike apo me ato të emigruara, që nuk janë fashitur, madje ka ndodhur e kundërta. Kudo, pakicat etnike, gjuhësore, të gjitha grupe të izoluara, janë në zhdukje apo shfarosje e sipër.

Milloseviçi është flamurtari i purifikimit, por kjo dukuri është e pranishme kudo në një optikë politike përtej të gjitha vetëmburrjeve për autonominë dhe të drejtat e njeriut; të gjitha shtetet europiane, si të tilla (nuk flas për popullatat, por çfarë janë këto, në mos kasa e kumbimit ideologjik e njerëzor të informacionit), nuk mund të mos jenë në fund të fundit bashkëpunëtorë me Milloseviçin, – me rrezikun që ta mohojnë si ndërgjegjen e keqe dhe të shtiren sikur e ndëshkojnë, sepse ai bën tepër mirë (domethënë tepër keq, tepër brutalisht punën e tij). Por do t'i lihet e gjithë koha për ta bërë. Përse të ankohesh pareshtur që nuk u ndërhy një, dy, tre vjet më parë (ka pesëmbëdhjetë vjet që gjërat vazhdojnë kështu) dhe përse, për çfarë mosnjohje habitëse të situatës, NATO përdori trupat ajrore, pa u merakosur se ç'do të ndodhte në tokë (kur një pafundësi ekspertësh e ka menduar me muaj të tërë) dhe përse të mos bllokohen menjëherë forcat tokësore serbe në Kosovë, por përdoret gjithë kjo logjistikë ajrore pak a shumë e kotë? Natyrisht, – gjithçka duket e qartë, nëse përfytyrohet që forcat ajrore janë atje për të mos ndërhyrë nga toka, ose për ta vonuar sa më shumë të jetë e mundur këtë ndërhyrje, – kur gjithçka të ketë mbaruar.

Solana e ka thënë troç (pa u merakosur se po tradhëton hapur vërtetësinë politike të kësaj lufte): "Nuk do t'i vazhdojmë bisedimet me Milloseviçin (pra nuk kërkohet më që ta heqin qafe), veç nëse do t'i jepet fund spastrimit etnik", – vini re me kujdes: kur të ketë përfunduar tërësisht. Gjë që ndodh egërsisht. Në këtë kuptim, kjo luftë, – a të paktën operacioni që, me sa na japin të shohim, është në bazë të kësaj lufte, – zhvillohet në mënyrë optimale, gjer edhe të programuar. Sepse Milloseviçi është ekzekutuesi i politikës europiane, e vërteta, e vetmja, ajo e një Europe të bardhë, të pastër, të spastruar nga të gjitha minorancat, – politikë negative, politikë ekskluzive e integraliste. Por përse të krijosh iluzione, Europa nuk ka Europa nuk ka kurrfarë ideje pozitive për vetveten, Europa është e obsesionuar nga fantazma e Europës, – për të gjitha këto arsye shtiremi sikur e luftojmë, por përherë tepër vonë dhe keq. Sidoqoftë nuk ka mbaruar: pas Kosovës, Mali i Zi, porsi gjetkë Kurdistan, Palestina, etj. (tragjikomedia e "procesit të paqes" në Lindjen e Mesme është një shembull i përsosur i kësaj "vonese" të papërcaktuar e të programuar).

Por punët janë ende më të ndërlikuara. Sepse, nëse Europa ka një politikë të përcaktuar, edhe nëse jo të vendosur, atë të një koalicioni të ardhshëm entitetesh kombëtare, që kanë qeverisur brenda kufijve të tyre (përndryshe, si të konsolidohet në nivel botëror para syve të Amerikës?) dhe sigurisht jo multikulturore e multiraciale. Amerika, nëpërmjet NATO-s, ka edhe ajo një strategji po aq të përcaktuar. Pasi mposhti komunizmin, në fund të një lufte tridhjetëvjeçare të ftohtë e të shkrirë botërore, pasi e asgjësoi fuqinë tjetër që e kërcënonte nga më afër, Japoninë, falë një destabilizimi të bursave aziatike, edhe ai gjerësisht i programuar, Europa është tanimë në shënjestrën e saj dhe objektivi amerikan është t'u japë shah mat për një kohë sa më të gjatë të jetë e mundur dëshirave të përealizueshme të kohezionit multikombëtar europian, që do të përbënte një kërcënim real. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë objektiv është destabilizimi i Bashkimit Europian, duke e zënë në çarkun e një lufte, që ai nuk e dëshiron dhe e që kompromenton mundësitë e tij të fundit, duke i ardhur në ndihmë minorancave (Bosnia, Kosova, kurdët, etj.), me të cilët Amerika nuk ka të bëjë fare e të cilët të gjithë, thellë-thellë brenda vetes, duan t'i heqin qafe, – përderisa Islami dhe fronti islamik janë fare hapur armiku numër një, si i vetmi thellësisht refraktar ndaj globalizimit në udhë e sipër, – këtu qëndron fronti i vërtetë i Luftës së Katërt Botërore. Ndaj do të bëhen doemos bisedime me Millosheviçin, do ta lenë të gjallë (ekzaktësisht si Saddam Husein), pjesërisht për të konsoliduar spastrimin etnik dhe pjesërisht për të turbulluar ujërat e Europës. Edhe prania tokësore e një force ndërkombëtare (e gjithë dykuptimësia e së cilës del sheshit në zgjatjen e masakrave në Bosnje), nuk do të ndryshojë asgjë.

Amerika pra e di përsosmërisht atë çka do – është për të të shkuar mendja që ekspertët e Pentagonit qenkan gieni (e njëjta politikë për Izraelin: të mbajë kudo vatrat e destabilizimit, të luajë rolin e policisë, duke u bërë në të njëjtën kohë përkrahëse e viktimave dhe bashkëpunëtore e xhelatëve). Por nuk është asnjëra nga të gjitha këto: është rrjedha e pashmangshme e Rendit të Ri Botëror që e kërkon dhe amerikanët nuk janë veçse ekzekutuesit. Kur europianët, të përfshirë në aksionin e NATO-s (por e kemi parë me sa rezerva), që punon kundër tyre, janë kredhur në një situatë të kokolepsur e të pazgjidhshme. Çdo shtet duhet të përballet sot me dy armiq themelore: minorancat e

veta dhe Amerikën. Të drejtojë njëkohësisht Rendin e Ri Botëror për atë që sa i takon (të eliminojë të gjitha elementet heterogjene e refraktare) dhe të pësojë efektet e një globalizimi në shkallë të gjerë, nga i cili Europa, me ç'po duket, është në të njëjtën kohë ndërmjetësja dhe viktimë. Praktikisht nuk ekziston ndonjë rrugëdalje. Mbetet streha e koalicionit njerëzor, në mungesë të një kohezioni politik – tjetër kontradiktë patetike, sepse ardhja në ndihmë viktimave, përderisa janë të tilla, nuk bën gjë tjetër veçse sanksionon suksesin e operacionit të spastrimit etnik. Por Benetton mund të gjejë frymëzim për reklamën e tij dhe sikush "duke lënë duhanin e duke ia kaluar paratë e cigares kosovarëve, do të mund të shpëtojë dy jetë në të njëjtën kohë".

Ekziston pra në këtë "luftë" një dykuptimësi themelore, aspekti më i vogël i së cilës nuk është ai që të na urdhërojnë të jemi pro apo kundër. Asgjë s'të lejon të marrësh një pozicion në një luftë, e cila është një karrem, e cila bëhet për të tjera arsye dhe objektivat e së cilës janë të maskuara, të parrëfyera e ndoshta edhe të fshehta për vetëdijen e këtij apo atij. Komentuesit ideologjikë, intelektualë e njerëzorë maskojnë me çdo mjet dhe vazhdimisht faktin që janë viktimë të arsyeve cinike e të fshehta të kësaj lufte. Të asgjësosh Millosheviçin? Do të thotë të mos shohim që jemi bashkëfajtorë. Të ndalosh gjithkë, të shkosh deri në fund të kujt gjëje? Do të thotë të mos shohim çfarë fshihet nën këtë luftë që kurrë nuk ka nisur vërtet, meqenëse kurrë nuk është dashur vërtet e që s'është veçse një prej episodeve të shumta që do të shfaqen për shkak të një konfrontimi, këtë herë vërtet real. Prej këtu buron vështirësia paradoksale për t'i dhënë fund një lufte që nuk është ajo e vërteta, dykuptimësia e së cilës është totale dhe objektivat e së cilës as që do të arrihen, – por që zhvillohet në realitet, pas këtyre dykuptimësive dhe këtyre manovrave false, krejt siç duhet zhvilluar.

Ndaj është absurde, në mes të mashtrimeve dhe dizinformimit, – që bën pjesë edhe ai në "katastrofën humanitare" (çfarë lapsusi!; o kjo katastrofë është humane, o është vetë humanitarizmi që bën pjesë në katastrofë), – të jesh pro apo kundër. Ajo çka duhet denoncuar dhe nxjerrë në dritë, është para së gjithash iluzioni i kësaj lufte. *Realpolitikës* i duhet kundërvënë një *Realanalizë*, – çka nuk pengon dhunën e reagimeve e të ndjenjave, që mund të shkaktojë ky globalizim hegjemonik. Por, për ta luftuar, duhet ditur, pas peripecive ideologjike në të cilat lufta dhe masmediat bëjnë

pjesë, kush në këtë botë janë me të vërtetë të mirët e të ligjtë. Nderim për ata që rasisën në anën e të ligjve.

Nderim dhe jo përdëllim. Aspak përdëllim për viktimat, por aspak mëshirë